



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i Tehnologije -  
Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

## **UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Kriteret dhe procedurat e akreditimit të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve**

**NUMËR: 4/2010**

**DATË: 27.04.2010**

Në bazë të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të neneve 12 paragrafi 5, 32 paragrafi 1, 32 paragrafi 2 të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë si dhe nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Përmes këtij Udhëzimi administrativ (më tutje në tekst “UA”), Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (më tutje në tekst “MASHT”) krijon një sistem të sigurimit të cilësisë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve në funksion të zbatimit të procesit të licencimit të mësimdhënësve në sistemin e arsimit parauniversitar.
2. Ky UA rregullon akreditimin e ofertuesve dhe programeve të zhvillimit profesional që ofrohen nga data 1 shtator 1999.

### **Neni 2 Përkufizimet**

1. **“Licenca”** – leja e punës e lëshuar në bazë të standardeve dhe normave të miratuara paraprakisht për punëtorët e arsimit që do të punojnë në institucionet e arsimit parauniversitar.
2. **“Licencimi”** – procesi i lëshimit të lejeve për ushtrimin e punës së mësimdhënësit dhe detyrave tjera në shkollë.
3. **“Punëtorët e arsimit”** – të gjithë individët që punojnë në shkollimin parauniversitar, të cilët janë përgjegjës për punët edukativo- arsimore (drejtorët, zëvendësdrejtorët, inspektorët e arsimit, këshilltarët, pedagogët, logopedët, edukatorët dhe mësimdhënësit)

- që janë në marrëdhënie pune në institucionet e arsimit parauniversitar.
4. **“Programe të zhvillimit profesional”** – trajnimet pa shkëputje nga puna, të akredituara nga institucioni i autorizuar me qëllim të aftësisë të kuadrit të institucioneve arsimore brenda sistemit të licencimit.
  5. **“Vlerësimi”** – Gjykimi i cilësisë dhe i vlerës së mësimdhënies, i bazuar në standardet e përcaktuara apo procesi i gjykimit të meritave dhe të arriturave të mësimdhënësit mbi bazën e standardeve dhe kritereve të krahasueshme me ato të vendeve të zhvilluara.
  6. **“Mësimdhënës”**- personi që ushtron procesin e edukimit dhe të arsimit në institucionet e arsimit parauniversitar (edukatorët e arsimit parashkollor(5-6 vjeç) mësimdhënësit e shkollës fillore, mësimdhënësit e shkollës së mesme të ulët dhe mësimdhënësit e shkollës së mesme të lartë).
  7. **“Akreditim i programeve të zhvillimit profesional”** – dhënia e vlerësimit pozitiv dhe e drejtës për zbatimin e programeve të trajnimit nga organizatat përkatëse në funksion të plotësisë të kërkesave të mësimdhënësve në procesin e licencimit.
  8. **“Performancë”**- Tërësia e punës dhe rezultateve të punës së mësimdhënësve, administratorëve arsimorë dhe të bashkëpunëtorëve profesional.
  9. **“Orë trajnimi”** - Në rastet specifike, në orë trajnimi përfshihen edhe orët e monitorimit dhe mentorimit nëse programi përkatës planifikon një gjë të tillë si edhe orët praktike në rastet e programeve të trajnimit që janë specifik për arsimin profesional.
  10. **“Programet themelore të trajnimit”** –programe të zhvillimit profesional të akredituara nga institucioni i autorizuar që fokusohen në çështjet lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien moderne. Këto programe mund të përfshijnë edhe programet e kërkuara nga MASHT për të siguruar zbatimin e reformave të caktuara në mësimdhënie dhe/ose shkollë në përgjithësi, zakonisht lidhur me ndryshimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë dhe mësimdhënien e lëndëve të caktuara.
  11. **“Programet plotësuese të trajnimit”** – programet e zhvillimit profesional të akredituara nga institucioni kompetent që nuk ndërlidhen drejtpërdrejtë me metodologjitë e mësimdhënies por janë në interes të ambientit të shkollës dhe shkollimit në përgjithësi.

### Neni 3

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e MASHT-it në fushën e zhvillimit profesional

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e MASHT-it në fushën e zhvillimit profesional janë:
  - 1.1. Të përcaktojë kriteret dhe standardet e përgatitjes dhe kualifikimit profesional që një person duhet t’i plotësojë për të marrë licencën për mësimdhënës, administrator arsimor apo bashkëpunëtor profesional.
  - 1.2. Të hartojë kriteret dhe kërkesat për zhvillim profesional të mësimdhënësve.
  - 1.3. Të krijojë sistemin e pagesës të bazuar në nivelin e shkollimit, në rezultatet e regjistruara në punë, në përparimin në karrierë dhe në përvojën e punës.
  - 1.4. Të krijojë sistemin e licencimit dhe të akreditimit të programeve të zhvillimit profesional, përmes të cilit do të stimulohej respektimi i standardeve të praktikës profesionale.
  - 1.5. Të përkrah materialisht dhe financiarisht asociacionet dhe institucionet që ofrojnë programe të zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

## **Neni 4**

### **Akreditimi institucional i ofertuesve të zhvillimit profesional**

1. Të drejtë aplikimi për akreditim institucional kanë të gjithë personat juridik të regjistruar në Kosovë dhe në vendet tjera që kanë programe zhvillimi profesional për punëtorë arsimi.
2. Organizatat që aplikojnë për akreditim institucional me qëllim të ofrimit të programeve të zhvillimit profesional duhet të dorëzojnë:
  - 2.1. Të dhënat themelore duke dëshmuar emrin, statusin, fushëveprimtarinë e organizatës;
  - 2.2. Referencat për aktivitetet e mëhershme;
  - 2.3. Të dhënat për personelin udhëheqës dhe personelin përgjegjës për aktivitetet trajnuese të organizatës.
3. Institucionet publike, qeveritare, ndërqeveritare dhe organizatat me status të njohur ndërkombëtar që kanë marrëveshje me MASHT për zhvillimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional të punëtorëve të arsimit konsiderohen të akredituara për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes.

## **Neni 5**

### **Akreditimi i programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve**

1. Organizatat që aplikojnë për akreditim të programeve të tyre duhet të dorëzojnë aplikacionin për akreditim duke përfshirë të dhënat në vijim:
  - 1.1. Historikun e zhvillimit/realizimit të programit të propozuar, nëse është e zbatueshme;
  - 1.2. Emërtimi i programit;
  - 1.3. Tipi i programit: themelor ose plotësues;
  - 1.4. Rezultatet e pritura ose objektivat e programit;
  - 1.5. Përmbajtja e programit;
  - 1.6. Metoda e punës për realizimin e programit;
  - 1.7. Grupi i synuar i mësimdhënësve;
  - 1.8. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në sesionet e trajnimit;
  - 1.9. Metodatat e vlerësimit të arritjes së rezultateve të pritura nga programi;
  - 1.10. Materialet që do të përdoren në zbatimin e programit;
  - 1.11. Biografia dhe përvoja e ligjëruesve të programit;
  - 1.12. Forma e certifikatës që dëshmon pjesëmarrjen në program.

## **Neni 6**

### **Procedurat e aplikimit**

1. MASHT shpall kërkesën për oferta të organizatave në fillim të çdo viti kalendarik duke përfshirë edhe kriteret e akreditimit dhe aplikacionin e nevojshëm që duhet të plotësohet.
2. Në rastet kur organizata e akredituar ka një ofertë re, ajo mund të paraqesë kërkesë me shkrim për akreditim te Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM) në çdo kohë të vitit.
3. KSHLM duhet të ofrojë një përgjigje në formë të shkruar më së largu një muaj nga data e aplikimit.

## **Neni 7**

### **Procedurat e akreditimit**

1. Organizatat paraqesin aplikacionin me të dhënat e kërkuara sipas nenit 4 dhe 5 me rastin e aplikimit për herë të parë ndërsa më tutje vetëm të dhënat sipas nenit 5.
2. KSHLM formon komisionet për shqyrtimin e propozimeve.
3. KSHLM lëshon vendim për akreditim në afatin e specifikuar në nenin 6 paragrafin 3 dhe një kopje i dërgohet organizatës që aplikon, një kopje i dërgohet sektorit të trajnimeve në MASHT dhe një kopje mbetet në dosjet e KSHLM-së.
4. Vendimi për akreditim përcakton tipin e programit: themelor ose plotësues.
5. Vendimi për akreditim mund të përcaktojë edhe llojin dhe nivelin e licencës për të cilën janë të destinuara programet.
6. Vendimi për akreditim përcakton afatin e vlefshmërisë së akreditimit institucional si dhe të çdo programi veç e veç. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 vit dhe më i gjatë se 5 vjet.

## **Neni 8**

### **Hartimi i Katalogut**

1. Sektori i trajnimeve në MASHT harton katalogun e programeve të akredituara pas shpalljes së rezultateve në bazë të ftesës për oferta sipas nenit 6 paragrafit 1.
2. Katalogu në formë të shtypur dërgohet në të gjitha Drejtoritë komunale të arsimit dhe përmes tyre në të gjitha shkollat.
3. Katalogu përmban edhe udhëzime për mënyrën se si mësimdhënësit mund të kenë qasje në këto programe.
4. Në rastet kur programet akreditohen sipas nenit 6 paragrafit 2, të dhënat për programet e tilla shpërndahen tek Drejtoritë komunale dhe përmes tyre tek shkollat menjëherë pas akreditimit.
5. Të dhënat për programet e akredituara publikohen në formë elektronike edhe në web-faqen e MASHT së bashku me udhëzimet e tjera për qasjen në këto programe.

## **Neni 9**

### **Akreditimi i programeve të realizuara në të kaluarën**

1. Programet e zhvillimit profesional të realizuara nga data 1 shtator 1999 mund t'i nënshtrohen procesit të akreditimit në mënyrë retroaktive sipas procedurave dhe kritereve të njëjta të parapara në këtë UA.
2. Nismën për akreditim mund ta parashtrojë ofertuesi i programit ose institucioni tjetër që ka interes për akreditimin e atij programi.
3. Programet e akredituara në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, do të merren parasysh në procesin e licencimit të mësimdhënësve .
4. Nëse realizimi i programit të akredituar nga paragrafi 1 i këtij neni ka filluar para datës 1 shtator 1999, ndërsa ka përfunduar më 1 shtator 1999 ose pas kësaj date, atëherë të gjitha orët e realizuara pas datës 1 shtator 1999 do të merren parasysh në procesin e licencimit të mësimdhënësve.

**Neni 10**  
**Mekanizmat e ankesës**

1. Ankesat ndaj procesit të akreditimit të programeve të zhvillimit profesional të mësimeve mund të bëhen në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës në MASHT.


**Neni 11**

**Dispozitat shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ shfuqizohen të gjitha dispozitat që e kanë rregulluar këtë fushë.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri .

  
**Enver Hoxhaj, ministër**